

ANKETIM: ARSIMIMI & TRAINIMI PROFESIONAL NË SHQIPËRI

Bizneset kërkojnë fuqi punëtore më të kualifikuar në Shqipëri


Një sistem dual i arsimit profesional, ku teoria dhe praktika mësohen të kombinuara përgjatë gjithë procesit të arsimit, ashtu si prej kohësh zbatohet në mënyrë shumë të suksesshme në Gjermani e disa vende të tjera perëndimore, mungon në Shqipëri. DIHA, Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, ka bërë një anketim, në mënyrë që të mbledhë opinionet e bizneseve që veprojnë në Shqipëri, lidhur me kërkesën dhe ofertën për arsim profesional në Shqipëri.

Rezultatet

- 91% e pjesëmarrësve në anketim do të mbështesnin një sistem dual të arsimit profesional, duke ofruar praktika për studentët e këtyre shkollave, ndërkohë që 96% e tyre do të ishin të gatshëm të paguanin paga më të larta për punonjësit që do të kualifikoheshin në këto shkolla.
- Megjithatë, vetëm 73% e tyre do të ishin të gatshëm të lejonin nëpunësit e tyre të ndiqnin shkollën gjatë orarit të punës. Kjo dëshmon se me gjithë dëshirën e bizneseve për të mbështetur sistemin dual të arsimit profesional, do të ishte e vështirë që ky model të aplikohet në masë brenda një kohe të shkurtër, për vetë faktin se bizneseve u duhet pak kohë për tu përshtatur në mentalitet me sistemin e ri, si dhe për të përshtatur me të proceset e tyre të prodhimit.
- 85% e bizneseve shprehen se ofrojnë praktika për studentët. Kjo dëshmon edhe një herë se gatishmëria për të ndihmuar në formimin profesional të të rinjve ekziston dhe është tashmë koha e duhur për të ndjekur modele të suksesshme për t'i bërë këto praktika më eficiente, duke i përfshirë praktikantët, si një pjesë integrale e proceseve të punës.
- Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në anketim (rreth 64% e tyre), shprehen se e njohin modelin dual të arsimit profesional, ndërsa rreth 20% e tyre nuk e dinë ende se në Shqipëri ekzistojnë aktualisht shkolla profesionale.

Të pyetur mbi cilësinë e shkollave profesionale në Shqipëri, pjesa më e madhe e kompanive i vlerësojnë ato në një nivel mesatar ose nën mesatare. Për më tepër, një pjesë e të anketuarve shprehen se cilësia e këtyre shkollave ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit. Arsyet kryesore: programe mësimore të paaktualizuara, të cilat nuk u përgjigjen kërkesave të bizneseve, shumë pak praktikë e përfshirë në procesin e mësimdhënies, mësues jo të kualifikuar siç duhet dhe mospërkushtim i duhur i studentëve. Si rezultat, shumë prej kompanive janë në kërkim të fuqisë punëtore të kualifikuar, e cila aktualisht mungon në tregun e punës në Shqipëri.

Vlerësimi i cilësisë së shkollave profesionale në Shqipëri



(1 = shumë mirë, 5 = shumë keq)

- Një tjetër aspekt që mungon, është edhe **çertifikimi i këtyre profesioneve** dhe kuadri ligjor lidhur me rregullimin e sektorëve të caktuar, në mënyrë që në profesione të caktuara ku është e nevojshme, të punojnë vetëm profesionistë të certifikuar dhe kjo të inspektohet. Kjo do të rriste standardet e cilësisë së prodhimit dhe do t'i bënte shkollat profesionale më tërheqëse për nxënësit/studentët potencialë.
- **Korrupsioni**, si një problem që haset fatkeqësisht shpesh e pothuaj në cdo fushë në realitetin shqiptar, është përmendur nga shumë prej bizneseve, si një pengesë e konsiderueshme për nivelin e cilësisë së arsimit profesional.
- Bizneset kanë nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar **në fusha të ndryshme e kryesisht**: teknologji ushqimore, prodhim dhe përpunim qumështi, kuzhinier, kamarier, mirëmbajtëse hoteli, turizëm, industri e veshjeve dhe këpucëve, riparim i makinerive të prodhimit (mjekësore, tekstile, ushqimore, etj.), ndërtim, elektrik, hidraulik, elektronikë, mekanik, saldim, gjeologji – miniera, industri metalesh, infrastrukturë, logjistikë, porte, bankë dhe administrim.
- Më shumë se 50% e pjesëmarrësve janë të mendimit se këto lloj kualifikimesh ekzistojnë në Shqipëri. Megjithatë, 50% e kompanive **i dërgojnë punonjësit e tyre jashtë vendit për trainim**.
- Në pothuaj gjysmën e kompanive, më tepër se sa 70% e punonjësve kanë përfunduar studimet universitare, ndërkohë që universitetet shtetërore janë dukshëm më të preferuara, duke qenë se ¾ e bizneseve kanë më pak se sa 30% të punonjësve që vijnë nga universitete private. Për sa i përket arsimit profesional, vetëm më pak se 20% e bizneseve kanë punësuar një numër të konsiderueshëm punonjësish që vijnë nga shkollat profesionale.

Shpërndarja e kualifikimeve të punonjësve në kompanitë Shqiptare:


	none	less than 30%	30 - 50 %	50 - 70 %	70 - 100 %
State University	4.20%	18.70%	14.60%	20.80%	41.70%
Private University	28.60%	50%	3.60%	10.70%	7.10%
Foreign Universities (studied abroad)	21.90%	50%	12.50%	6.20%	9.40%
Professional schools	35.50%	48.40%	6.50%	6.40%	3.20%
Profession learned abroad	50%	32.10%	7.10%	0%	10.70%
High School (12 years)	9.70%	32.30%	12.90%	19.30%	25.80%
Elementary school (9 years)	36%	24%	4%	4%	32%

Mbi Anketimin

Ky anketim është bërë në tri gjuhë: Shqip, Gjermanisht dhe Anglisht dhe u është dërguar të gjithë kompanive anëtare të DIHA-s, si dhe kompanive të tjera.


Më shumë se sa gjysma e pjesëmarrësve në këtë anketim janë shqiptarë, ndërkohë që gjysma tjetër përbëhet nga gjermanë, austriakë, etj..

Selite qendrore te te anketuarve



Vetëm rreth 10% e kompanive pjesëmarrëse punojnë në infrastrukturë apo turizëm, edhe më pak në industri të lehtë e bujqësi, ndërkohë që rreth 40% e të anketuarve punojnë në fushën e shërbimeve dhe 30% në degë të tjera, gjë që pasqyron deri diku edhe përbërjen sektoriale të ekonomisë shqiptare.

Shpërndarja sektoriale e të anketuarve



Rreth Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) është një shoqatë e pavarur, e krijuar nga kompani të ndryshme në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Tiranë. DIHA ka aktualisht 68 kompani anëtare dhe po zgjon gjithmonë e më shumë interesin e biznesit.

DIHA përfaqëson interesat e biznesit gjerman në Shqipëri. Ajo nxit marrëdhëniet bilaterale të biznesit dhe jep konsulencë për kompanitë gjermane dhe shqiptare në lidhje me bashkëpunime të mundshme dhe zhvillime të tregut. Nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi, DIHA është e lidhur me rrjetin e Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK). AHK ka në të gjitha ato vende, të cilat janë me interes për ekonominë gjermane, dhe më konkretisht, në rreth 85 shtete me rreth 130 zyra.